

**PROCESVERBAL**  
**Nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë**  
**për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele**  
**e mbajtur më 10.03.2022**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëv-kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

**Anëtarët që mungojnë në Këshillin e Agjencisë:** /

**Në seancë ishte i pranishëm dr.Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** mr.Dragica Ljubevska, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, Goran Radunoviq, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të tjerë të pranishëm:** /

Z.Petrushevski e hapi seancën e 9-të të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:10 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z.Petrushevski në lidhje me propozimin e Rendit të ditës shpjegoi se pika nr.2-Propozim për fillimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim TV ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKPV, Veles, nr.08-50 nga 05.01.2015 do ta renoncoj nga propozimi i Rendit të ditës sepse ndërkohë TV Zdravkin bëri pagesën dhe ka paraqitur provë. Me këtë ndryshim Rendi i ditës në vend të 11-të pikave do të ketë 10-të pika.

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimin, miratoi njëzëri si në vijim:

**RENDI I DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ,e mbajtur më 03.03.2022.
2. Propozim–vendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve Shoqërinë tregtare transmetuese SITI TELEVISION SHPKPV Shkup.
3. Propozim për sugjerim me shkrim deri tek SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKPVShkup për shklje të nenit 61 paragrafi 1 alineja 5 nga LSHMAV.
4. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar për shkelje të nenit 64 paragrafi 1 nga LSHMAV.
5. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR G-TV TELEVISION SHPKPV Gostivar për shkelje të nnenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV.
6. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV GURRA SHPKPV Kërçovë për shkelje të nenit 92 pragrfi 1 dhe 3 nga LSHMAV.
7. Propozim për shqiptim të masës vërtjje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV.

8. Propozim për dhënien e pëlqimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës për furnizim publik - shërbime: Kontroll i jashtëm i IKT sistemit (Teknologjia e komunikimit informatik) në pajtueshmëri me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Propozim për dhënien e pëlqimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës - shërbime: Mirëmbajtjen preventive dhe adaptive të softuerit të itegruar për punë juridike, finansiare dhe ekonomike.
10. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë e shikoi dhe me 5-së vota „për“ dhe një abstenim nga z. Trajçevski e miratoi Procesverbalin nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e mbajtur më 03.03.2022, në tekst siç ishte propozuar.

### **Pika 2**

Z.Trajçevski e arsyetoi Propozim–vendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë tregtare radiodifuzive SITI TELEVISION SHPKPV Shkup. Sqaroi se ky transmetues pranë Agjencisë ka paraqitur një deklaratë me shkrim se do të ndalojë kryerjen e veprimtarisë dhe në këtë rastë sipas detyrës zyrtare mbaron së vepruari leja. Meqë vetë radiodifuzeri ka paraqitur kërkesë të noterizuar, në pajtim me Ligjin tani mbetet vetëm detyrimi për fshirje nga regjistri i transmetuesve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri solli Vendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë tregtare transmetuese SITI TELEVISION SHPKPV Shkup.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta shpallë në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 3**

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për punë programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova e arsyetoi Propozimin e sygjeruar me shkrim deri tek SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKPV Shkup për shkelje të nenit 61 paragrafi 1 alineja 5 nga LSHMAV. Shpjegoi siç dhe mund të shihet nga materialet që janë paraqitur në Këshill, mbikëqyrja e programit ishte kryer pas marrjes së kërkesës për shpjegim, informacione dhe dëshmi për pretendimet në ankesë, të paraqitura nga ana e personit fizik deri tek Avokati i popullit – zyra rajonale Kërçovë, dhe më pas përcillet te Agjencia e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale.Në ankesën e drejtuar Avokaktit të popullit, parashtruesi deklaroi se në disa media i është shkelur e drejta për prezumimin e pafajësisë. Edhe pse nuk është miratuar akoma një aktgjykim i formës së prerë në çështjen e tij gjyqësore në media është shpallur emri i tij i plotë dhe mbiemri dhe të dhëna të tjera personale.Agjencia si kompetente vetëm për një nga mediat, për TV Telma, bëri mbikëqyrje në bazë të nenit 61 nga LSHMAV dhe ishte konstatuar se në shtojcën e emisionit „KOD“ janë shpallur emri dhe mbiemri si dhe vendi dhe adresa e vendbanimit dhe lindjes e cila realisht cenon të drejtën e prezumimit të pafajësisë.

Gjithashtu shpjegoi se dhe vetë sektori ka qenë i kujdesshëm që të mos shkelet e drejta e prezumimit të pafajësisë. Avokati i popullit i cili kishte lënë në dispozicion afat kohor prej 8-të ditësh tashmë i është thënë se është vepruar, është bërë mbikëqyrje dhe se aktivitetet e mëtejshme do të ndërmerren pas mbajtjes së seancës së Këshillit. Për këtë arsye propozohet të shqiptohet një sugjerim me shkrim sepse parimet për kryerjen e veprimtarisë nga neni 61 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale janë subjekt vetërregullator dhe Ligji nuk parashikon dispozita ndëshkuese.

Z. Petrushevski shtroj pyetje drejtuar udhëheqëses nëse ajo mendon se kjo është mangësi e Ligjit apo është e drejtë të mos ketë masë?

Udhëheqësja Petrevska Kamenjarova u përgjigj se standartet profesionale dhe monitorimi i tyre janë çështje të vetërregullimit dhe atje duhet zbatuar. Shërbimi sigurisht i ndjek, por nuk mendon se si rregullator duhet të ketë dënime për këto çështje.

Z. Petrushevski tha se në material thuhet se për shkelje të këtij neni nuk ka masë ligjore të parashikuar dhe atëherë nuk duhet shënuar në material se nuk ka masë për këtë lëndë.

Udhëheqësja Petrevska Kamenjarova theksoi se është e nevojshme të thuhet pse propozon sugjerim, në pajtueshmëri me Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore.

Z. Petrushevski tha se tani është në rregull sepse e kuptoi idenë.

Z. Fidanovski tha se sipas tij nuk duhet të jenë funksion i censurës pra ligjërisht ti sanksionojnë mediat për këto çështje. Parashtrroi pyetje cili është interesi publik për këtë ose raste të ngjashme si ky, siç është aksidenti rrugor ku ka një jetë njerëzore të humbur, dhe s'është një, shumë janë në vend dhe nëse mbrohet në këtë rast ose nuk është i mbrojtur me supozimin e avokatit të popullit i cili ndër të tjera i drejtohet dhe Agjencionit. Personalisht mendoj se nuk është mbrojtur ai për shkak se interese publik i mediave është për të mbrojtur interesin publik, ndërsa interesi publik në këtë rast nuk është mbrojtur nëse nuk paralajmërohet, nuk tregohet i drejtpërdrejtë me këtë shembull dhe me shembuj të tjerë aq sa arrinë të ndjekë njoftimet nga mediat, kërkoi falje për përdorimin e fjalëve brutale, për dhënien e makinës si egërsira për të cilët janë dëshmitarë aksidentet në Shkup si dhe më gjerë në të gjithë vendin dhe ku kositen jetë njerëzish si shishet e gjuajtura me gjyle. Kërkoi falje për fjalorin, por tha se duhet të jetë piktotersk. Theksoi se në të njëjtin mision, e ka shikuar origjinin atëherë ndërsa sot e ka rishikuar dhe një herë para fillimit të seancës, ka një shembull të ngjashëm ku bëhet fjalë për humbje të jetëve njerëzore në aksident rrugor dhe me marrëveshje i ishte dhënë vetëm 6-të muaj burg dhe autori u tregua me emër dhe mbiemër, bëhet fjalë për personin Z.M.K. dhe mendon se është mirë që u tregua. Po ashtu që në kohë të kaluara ishin numëruar emrat të shkelësve pra të shoferëve të atyre që u bënë shkaktarë të aksidenteve rrugore për jetë të humbura, dhe nuk paska reagime nga Avokati i popullit për raste të tilla dhe mendon se kjo ka qenë e drejtë. Sipas përvojës së tij po të mos ishte aksidenti rrugor tek Qenda tregtare Shkup Siti Moll nuk kishte për tu parë aq kontroll i rreptë policor në 40 deri 60 ditë nëpër rrugët e qytetit kryesor dhe dëshmitarë janë se dhe më parë ka pasur me të vërtetë egërsi në dhënien e makinës nga shumë shoferë që bëhen shkaktarë për tragjedi të tilla në të cilën humbin jetë dhe ky është dëm që ska çmim. Ai pyeti se si ndihen prindërit e personit të humbur në të tilla aksidente? Sipas tij ideja e medias në këtë rast është nën presionin e publikut të mos lejojnë asnjëherë kurr të merren vendime për raste të tilla të bëjnë një sanksion minimal ose kushtëzues për atë që do të pendohet publikisht

para gjykatës për veprën e kryer, megjithatë sipas tij kjo nuk ja ul fajin, sepse ai me vetëdije ka kryer një shkelje, me vetëdije i jep makinës më shpejtë se sa është e lejuar, nuk e përshtat shpejtësinë me kushtet e rrugës siç thuhet në Ligji dhe ka kryer vepër penale. Ka plotë shembuj që pendohen, kërkojnë falje dhe më pas 6-të muaj, 1 vit, një vit e gjysëm do të vuajnë dënimin, ndërsa jeta e viktimës nuk kthehet më. Për këto arsye konsideroj se ideja e kësaj shtojce ose pjesë e emisionit ishte që të ushtrohet presion, gjyqësia të përfundojë punën e saj dhe kryesit e veprave të tilla penale të sanksionohen në mënyrë adekuate si mësim për të gjithë në të ardhmen. Nëse e pyesni atë, nuk e dinë nëse po ndërmerret ndonjë iniciativë, po nëse pyetem unë ai është këmbëngulës për shtrëngim drastik të sanksioneve për krime të tilla penale sepse me të vërtetë ajo që po ndodh nëpër rrugët e Maqedonisë është haus. Prandaj konsideroj se në këtë rast mediat nuk kanë gabuar që i kanë shpallur me emër dhe mbiemër për shkak se ka mbrojtur interesin publik dhe na mbetet të shpresojmë që në këtë mënyrë do të mund të vihet pak drejtësi konkretisht për këtë rast në të cilin ka një të vdekur, jetë njerëzore e humbur. U shpreh se për këto shkaqe nuk pajtohet me rekomandimin në Raport për miratimin e konkluzionit për tu dhënë një tregues me shkrim medias. Konsideron se nuk është e nevojshme, kjo është punë e fellës, këtë propozim ta rishikojnë në KEM (Këshilli për etikë i medias) dhe të vendosin se çfarë mendojnë, nëse TV Telma ka shkelur parimet etike ose jo. Personalisht mendojë se interesi publik në këtë rast është më i lartë nga ajo që është bërë dhe për atë arsye nuk ka për ta pranuar Raportin.

Udhëheqësja Petrevska Kamenjarova: shpjegoi se askund në Raport nuk kontestohet interesi publik, vetëm matet nëse respektohet me Kushtetutë e drejta e garantuar për prezumimin e pafajsisë. Kushtetuta e vendit thotë se deri në një aktgjykim të formës së prerë ai që është akuzuar për një vepër të caktuar konsiderohet i pafajshëm. Pikërisht këto janë formulimet që sektori i ka përdorur në Raport. Në rastin konkret ajo që është bazë e konkluzionit është shkella e nenit 61 paragrafi 1 alinea 4 nga LSHMAV përkatësisht principin e respektimit të prezumimit të pafajsisë sepse në momentin kur është transmetuar ajo shtesë, interesi publik është i padiskutueshëm, në atë moment akoma kemi procedurë ankimi para apelacionit në Gostivar dhe nuk është sjellë akoma aktgjykim i formës së prerë. Sinqerisht nuk mendon se do të ishte arritur një efekt më i vogël nëse personi në fjalë, ku emri dhe mbiemri i tij do të ishte shpallur me iniciale. Azgjë nuk është e diskutueshme në publikimin e shtojcës, në të vërtetë është me interes publik veçanërisht për numrin e madh të aksidenteve që i kemi, të informohen në lidhje me këtë pyetje, të intervenohet në situatën e radhës, por Kushtetuta dhe Ligji thonë se personi i akuzuar gëzon të drejtat e veta deri në aktgjykim të formës së prerë dhe mediat duhet t'i përmbahen kësaj. Kjo është arsyeja pse në fakt është përfshirë në Ligj.

Z. Fidanovski tha se me vëmendje e dëgjoi dhe e kuptoi arsyetimin, megjithatë nuk është i bindur për të kundërtën dhe prandaj qëndron në mendimin e shprehur.

Z. Petrushevski tha se qëndrimi i tij është se do të mbështesë propozimin e deklaruar nga shërbimi në Raport për shkak se sado që të jetë fajtor, personi i veprës ka të drejtën e Ligjit për prezumimin e pafajsisë dhe vetëm për këtë do të mbështesë propozimin. Ai tha se në këtë rast secili personalisht duhet të vendosë se si do të deklarohej, si do të jetë rezultati i zgjedhjeve nuk mund të dihet paraprakisht, por do të jetë pasqyrë e reflektimit të pikëpamjeve të secilit prej anëtarëve të Këshillit individualisht.

Këshilli i Agjencisë, bazuar në konstatimet nga Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative e realizuar me shpresë me shkrim për shpjegim nga Avokati i popullit – zyra qendrore Kërçovë nr.10-893/1 nga 03.03.2022 dhe në përputhje me Metodologjinë e

kryerjes së mbikëqyrjes programore nr. 01-3905/1 nga 23.07.2014, me 5 vota pro dhe një kundër nga z.Fidanovski e pranoi Raportin nga mbikëqyrja dhe solli konkluzion ndaj Shoqërisë tregtare transmetuese TELEVISIONIN MAKPETROL SHPKPV Shkup, me shkrim ti tregohet për shkeljen e konstatuar nga neni 61 paragrafi 1 alineja 5 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Parimet për kryerjen e veprimtarisë nga neni 61 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale janë subjekt i vetërregullimit dhe Ligji nuk parashikon dispozita ndëshkuese.

Spektori për punë programore të përgatisë sugjerimin me shkrim.

#### **Pika 4**

Ndihmës udhëheqësja e Spektorit për punë programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova e arsyetoi Propozimin për shqiptim e masës vërejtje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar për shkelje të nenit 64 paragrafi 1 nga LSHMAV. Shpjegoi se bëhet fjalë për një mbikëqyrje të jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare ku u konstatua se më 11 shkurt filmat vizatimorë „Masha dhe Medo“ dhe „Tom dhe Xheri“, pjesët në të cilat ka të folur janë dhënë fillimisht në rusisht dhe anglisht, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe, gjuhën në të cilën media transmeton programet në përputhje me lejen. Kjo shkelje është për të parën herë e konstatuar në këtë vit, është dhënë propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike dhe të obligohet në afatin e duhur të respektojë Ligjin dhe pas kësaj do të bëhet mbikëqyrje e kontrollit.

Këshilli i Agjencisë rishikoi Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së çrregullt të kontrollit, sipas detyrës zyrtare, mbikëqyrje programore, nr.10-777/1 nga 25.02.2022 dhe njëzëri konkluduan ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar ti shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi 1 nga LSHMAV sepse më 11 shkurt 2022 në filmat vizatimorë „Masha dhe Medo“ dhe „Tom dhe Xheri“, pjesët në të cilat ka të folur janë dhënë fillimisht në rusisht dhe anglisht, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe, gjuhën në të cilën mediumi transmeton programet në përputhje me lejen.

Në pajtim me pikën 5 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për shqiptim e masës (tekst i pastruar) nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, obligohet që në afat kohor prej 15-të ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Spektori për punë juridike dhe furnizim publik të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për punë programore pas skadimit të afatit të paraparë në Vendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur (transmetuesi) a ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar aspak).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pikat 5, 6 dhe 7**

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për punë programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova i arsyetoi propozimet për shqiptim e masës vërejtje publike ndaj SHTR G-TV TELEVISION SHPKPV Gostivar, SHTR TV GURRA SHPKPV Kërçovë dhe SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV. Tek të tre transmetuesit është kryer kontroll mbikëqyrës sepse masa vërejtje publike njëherë ishte shqiptuar për shkak të së njëjtës shkelje. Tek të gjithë u konstatua se nuk kanë respektuar ose eliminuar shkeljet kështu që dhe më tej nuk kanë transmetuar 30% të programit burimor vendas si vepra audiovizuele maqedonase, si dhe të paktën gjysmën e minimumit të paraparë ligjor për program me muzikë burimore vendase si vepra audiovizuele maqedonase, nuk kanë transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00. Edhe pse kemi të bëjmë me kontroll mbikëqyrës propozim është që përsëri tu shqiptohet masa vërejtje publike, mbikëqyrja e rregullt ka qenë më 2021 dhe për shkak të zhvendosjes në një vit kalendarik të ri gjithmonë masat rifillojnë dhe prej këtu propozohet përsëri për shqiptim të masës vërejtje publike për të tre transmetuesit.

Z. Petrushevski shpjegoi se udhëheqësja Petreska Kamenjarova bëri një hyrje për tre propozimet dhe hapi diskutim për tre masat e propozuara.

### *Votim sipas Pikës 5*

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për kontrollin e kryer programor mbikëqyrës, nr.10-776/1 nga 25.02.2022 dhe njëzëri konkluduan ndaj SHTR G-TV TELEVISION SHPKPV Gostivar për shqiptim të masës vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV sepse më 12 shkurt 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program burimor vendas si vepra audiovizuele maqedonase, si dhe së paku gjysmën nga minimumi i programit muzikë burimore vendase si vepra audiovizuele maqedonase, e transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Konkluzionin nr. 02-320/4 nga 24.01.2020, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë tregtare radiodifuzive G-TV TELEVISION SHPKPV Gostivar, dhe në pajtim me pikën 14 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, ka urdhëruar që në afat kohor prej 15-të ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisin vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Sektorit për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për shkak të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektorit për mbështetje të punës së drejtorit dhe Këshillit, të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votim sipas Pikës 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për kontrollin e kryer programor mbikëqyrës, nr.10-779/1 nga 25.02.2022 dhe njëzëri konkluduan ndaj SHTR TV GURRA SHPKPV Kërçovë për shqiptim të masës vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV sepse më 10 shkurt 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program burimor vendas si vepra audiovizuale maqedonase, si dhe së paku gjysëm nga minimumi i programit muzikë burimore si vepra audiovizuale maqedonase, e transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe Konkluzionin nr. 02-320/4 nga 24.01.2020, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV GURRA SHPKPV Kërçovë, dhe në pajtim me pikën 14 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, ka urdhëruar që në afat kohor prej 15-të ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisin vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për shkak të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetje të punës së drejtorit dhe Këshillit, të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votim sipas Pikës 7

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për kontrollin e kraer programor mbikëqyrës, nr.10-775/1 nga 25.02.2022 dhe njëzëri konkluduan ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar për shqiptim të masës vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 dhe 3 nga LSHMAV sepse më 11 shkurt 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program burimor vendas si vepra audiovizuale maqedonase, si dhe së paku gjysmën nga minimumi i programit muzikë burimore si vepra audiovizuale maqedonase, e transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe Konkluzionin nr. 02-320/4 nga 24.01.2020, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKPV Gostivar, dhe në pajtim me pikën 14 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës vërejtje publike nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, ka urdhëruar që në aft kohor prej 15-të ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për shkak të përcaktimit nëse subjekti i

mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetje të punës së drejtorit dhe Këshillit, të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 8**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës së furnizimit publik për lëndë e rradhës të furnizimit publik - shërbimi: Kontrolli i jashtëm i sistemit TIK (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit) në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale. Shpjegoi se ky furnizim është bërë me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta të mundshme në sistemin e komunikimit informativ që duhet të jetë në përputhje me Ligjin për të dhënat personale që është në fuqi. Identifikimi i pikave të dobëta të mundshme është në funksion të ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm për mbrojtjen e plotë të të dhënave personale me të cilat punon Agjencia. Ky furnizim është i paraparë në planin vjetor të furnizimit publik dhe mjetet janë të parapara në planin financiar. Sipas mjeteve të vlerësuara, që janë të parapara për furnizim. Do të bëhet si furnizim me vlerë të vogël, që do të thotë se do të respektohen dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Ai theksoi se të gjitha të dhënat e tjera janë të shënuara në materialet e dorëzuara sipas pikës.

Z. Trajçev tha se Këshilli merr vendim për të përcaktuar nevojën për furnizim publik. Ai ka shpjeguar se ka vërejtur sërish se çmimi është 50 pikë dhe cilësia është gjithashtu 50 pikë. Ai e ka shprehur qëndrimin e tij në këtë drejtim edhe më herët por do ta përsërisë si indikacion dhe në fund vendimi i takon Agjencisë dhe drejtorit se si do të veprojnë lidhur me realizimin e furnizimeve. Sipas tij, kjo mund të përcaktohet në një mënyrë tjetër se kush mund të marrë pjesë, por duhet shmangur cilësia e vetë ovulacionit si pikë. Ai tha se do ta mbështeste propozimin sepse ata votojnë vetëm për përcaktimin e nevojës.

Z. Petrushevski tha se qëndrimi i tij ishte identik me atë të mëparshëm. Ky është një shërbim intelektual dhe duhet në të vërtetë të mirret cilësi për këtë furnizim. Nuk bëhet fjalë për furnizim të sasisë, por ai që do ta bëjë duhet të ketë më shumë njohuri se punonjësit e Agjencisë dhe prandaj cilësia në këtë rast është e rëndësishme.

Z. Fidanoski tha se parimisht edhe ai ka diskutuar disa herë për disa çështje dhe obligime që janë duke u realizuar. Konsideron se është e nevojshme të bëhet një raport çmim-cilësi për të marrë një produkt përfundimtar më cilësor që do t'i shërbejë ose Agjencisë ose mbi të gjitha publikut sesa ajo që ka bërë Agjencia. Për këto arsye ai do të japë edhe mbështetje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratimin Drejtorit të Agjencisë për zbatimin e procedurës së furnizimit publik-shërbime : Kontrolli i jashtëm i sistemit TIK (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit) në përputhje me rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zbatimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën- shërbime: Kontrolli i jashtëm i sistemit TIK (Teknologjia e komunikimit të informacionit) në përputhje me rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor të furnizimit publik për vitin 2022 ( Teksti i pastruar) Nr.05-563/2 nga data 08.02.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2022.



## Pika 9

Z. Petrushevski lidhur me pikën tha se më në fund atë që z. Trajçev e kërkonte për një kohë të gjatë, Sektori i Informatikës ka bërë përpjekje dhe ka paraqitur qëndrimin dhe mendimin e tyre pse nuk duhet blerë kodi burimor. Është mirë që është bërë në këtë formë sepse vërtet shumë herë në vitet e kaluara z. Trajçev ka kërkuar që të bëhet.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje Juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e rradhës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punën juridike, financiare dhe ekonomike. Shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim që zbatohet për të siguruar mirëmbajtjen e softuerit të integruar për punën juridike, financiare dhe ekonomike që Agjencia e zbaton në veprimtarinë e saj të përditshme. Në furnizimin e vitit 2015, kodi burimor nuk është blerë, por ka mbetur në pronësi të bartësit të furnizimit. Prandaj, Agjencia është e obliguar që këtë procedurë ta zbatojë duke negociuar pa shpallur konkurs publik, në pajtim me nenin 55 paragrafi 1 pika V alinea 3 të Ligjit për furnizimin publik, bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale. Për të mundësuar realizimin e kësaj procedure është kërkuar Mendim nga Byroja e furnizimit publik për të marrë mendim juridik se janë plotësuar kushtet për zbatimin e kësaj procedure duke respektuar të gjitha dispozitat e Ligjit furnizim publik.

Z. Petrushevski tha se është shumë e rëndësishme që ka një mendim shtesë nga Byroja për furnizim publik si organ përkatës në këtë fushë, se e kanë kontrolluar dhe pajtohen që ky furnizim mund të bëhet me negociim.

Z. Trajçev falënderoi shërbimet, ai vazhdimisht kërkoi një analizë të tillë sepse ata si Këshill nuk janë aq profesional sa të kuptojnë gjërat për softuerin dhe kodet burimore, mirëmbajtjen dhe të ngjashme. Megjithatë, bëhet fjalë për ekspertë që dinë saktësisht të japin mendim në këtë fushë. Këshilli merr vendim për nevojën e furnizimit, dhe bëhet fjalë për paratë publike ku duhet bërë analizë se si shpenzohen dhe në të njëjtën kohë të shpenzohen në mënyrë sa më efikase dhe të përshtatshme. Duke pasur parasysh se ky opinion është paraqitur në materiale dhe shpjegon shumat për dy softuerët me kod burimor që nuk është në pronësinë tonë ashtu edhe analizën ku rezultoi se nuk është ekonomikisht më efikas dhe më i përshtatshëm që kodet burimore të jenë në pronësi të Agjencisë. me një softuer të ri por të përdoren aplikacionet ekzistuese dhe të paguhet për mirëmbajtjen, tha se në përputhje me këtë mendim të ekspertëve do të mbështesë pikën

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratimin Drejtorit të Agjencisë për zbatimin e procedurës së shërbimit për furnizim publik: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën- shërbime: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2022 të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ( Teksti i pastruar) Nr.05-563/2 datë 08.02.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe udiovizuale për vitin 2022.

Pika 10

Të ndryshme

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-915/10**

**16.03.2022**

**Sh k u p**

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale  
Kryetar i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI d.v**